



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr 1221/14 Prot

Tiranë më 08/01/2024

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar; VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkionimin e TKOBAP-së” me nr.1850 prot datë 25.07.2014, nisur nga rrethanat objektive, njofton se:

Audicioni për pozicionin e punës “Solist/e e Parë Baleti” pranë Drejtorisë së Baletit që ishte parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12/01/2024, ora 14:00 në Sallën e Baletit, do të shtyhet për t’u zhvilluar më 08.02.2024, ora 10:00.

Te gjithë artistët që janë të interesuar për t’iu nënshtruar audicionimit, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të TKOBAP-se deri në datën 01.02.2024, ora 16:30 dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme (dokumentacioni):

1. Të ketë kryer studimet ne shkollën e baletit ose ekuivalentin e saj brenda ose jashtë vendit;
2. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar në shtetin përkatës;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
4. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore, ose nje dokument ekuivalent me të;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore ose një dokument ekuivalent me të;
7. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto (veprimtaria në vite e certifikuar, master class, work shop, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje te ndryshme si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, eksperiencë pune për vendin që aplikon, tituj artistikë etj) me dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter;
8. Preferohet të ketë njohuri minimalisht të gjuhës angleze dhe italiane.
9. Të ketë minimalisht 2 (dy) vjet eksperiencë si balerin/ë në teatër ose në kompani profesionale baleti.

Kandidati/ja duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Te mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykates për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje e certifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Program i detyruar:

- Ushtrimet e baletit (të gjithë balerinët konkurentë, shtetas shqiptarë dhe të huaj);
- Dy variacione nga repertori klasik botëror (me karakter të ndryshëm nga njëri- tjetri);
- Adagio Repertori i cili do të kërkohet nga komisioni;
- Improvizim sipas kërkesës së komisionit.

Informacion: Kohëzgjatja e ushtrimeve të baletit: 1 orë e 15 minuta.

10 minuta pushim, konkurentët përgatiten për pikën 2.

Të gjithë konkurentet do të performojnë variacionin e 1-rë dhe më pas të 2-in.

Koha e përgatitjes së Adagio-s nga konkurentët do të jetë 30 minuta.

Shënim: Konkurenët do të debutojnë me njëri-tjetrin, por për çdo eventualitet një çift nga trupa e baletit do të jetë në dispozicion për pjesëmarrësit.

Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.

Për sqarime të mëtejshme ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën e e-mailit: sekretaria@tkob.gov.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ABIGEILA VOSHTINA

NË MUNGESË DHE ME POROSI

DREJTOR I DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

METILA DYLGJERI

